



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

**BASHKIA KRUIJE**

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**Nr 4871 prot**

**Kruje më, 12.06 .2026**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të Këshillit të Ministrave, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Kruje shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

- **1 (një) Pozicion –Specialist Bujqësie, Drejtoria e Menaxhimit të Tokës dhe Pronës , Kategoria e pagës IV-2.**
- **1 (një) Pozicion - Specialist pronash , Drejtoria e Menaxhimit të Tokës dhe Pronës , Njësia Administrative Fushë Krujë, Kategoria e pagës IV-3.**

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE 22.06.2026 .

Afati për dorëzimin e dokumentave për pranim në SHËRBIMIN CIVIL : 29.06.2026.

• **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin:**

➤ **Specialist Bujqesie, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Tokës dhe Pronës, Bashkia Krujë ,**

1. Grumbullon dhe sistemon dokumentacionin kadastral të ri për tokën bujqësore dhe kategoritë e resurseve të reja.
2. Plotësimi i regjistrit të tokës bujqësore duke u mbështetur në dokumentacionin ekzistues dhe dokumentacionin e ri të krijuar.
3. Bën ndryshimet përkatëse në nivel ngastre, parcele apo fshati sipas vendimeve të marra nga organet shtetërore.
4. Kontribuon në vjeljen e taksës së tokës bujqësore në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
5. Është pjesë e zgjidhjes së konflikteve dhe pretendimeve të pronësisë mbi tokën ndërmjet pronarëve.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

6. Evidenton sipërfaqet e tokave bujqësore të dëmtuara nga erozioni, përmbytja, rrëshqitja dhe faktorë të tjerë natyrore.

*Ka detyrimin të përmbushë cdo urdhër tjetër apo porosi (me shkrim dhe me gojë) të eprorëve , që nuk përfshihet në pikat me lart, që nuk përbëjnë shkelje ligjore, dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.*

➤ **Specialist pronash, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Tokës dhe Pronës, Njësia Administrative Fushë Krujë, Bashkia Krujë ,**

1. Përgjigjet për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e pronave të bashkisë, pranë Njesisë Administrative përkatëse.
2. Kontrollon gjendjen e pronave dhe sipas gjendjes se tyre i liston ato ne vete.
3. Hap dosje te vecanta për cdo pronë dhe mban shënimet përkatëse ne dosje.
4. Përgatit dokumentat përkatëse për heqjes nga inventari për prona që nuk kanë ekzistuar fare.
5. Merr pjesë në procese të inventarizimit të pronave publike në Njësinë Administrative Përkatëse.
6. Përcjell pranë drejtorisë përkatëse dokumentacione të njësisë administrative përkatëse.
7. Jep pergjigje ligjore dhe teknike per problemet specifike qe mbulon sipas detyrave qe i ngarkohen.
8. Hap dosje të vecanta për cdo pronë dhe mban shënimet përkatëse në dosje.

*Ka detyrimin të përmbushë cdo urdhër tjetër apo porosi (me shkrim dhe me gojë) të eprorëve , që nuk përfshihet në pikat me lart, që nuk përbëjnë shkelje ligjore, dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.*

## **1. LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit Master në shkencat Inxhinierike/ natyrës;
- b- Preferohet të ketë eksperiencë pune, në fushën përkatëse;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës; (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njesimi nga Ministria Arsimit dhe Sportit.
- c- Fotokopje e deshmisë së gjuhës së huaj;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datë **24.06.2026** Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit, në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe pranë Zyrës së Punës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për lëvizjen paralele. Po në të njëjtën datë do të njoftohen nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore kandidatët të cilët nuk kanë plotësuar kushtet dhe kërkesat e posaçme.

## **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

- Kandidatët do të testohen në lidhje me:
  - a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
  - b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
  - c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar
  - d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139 /2015 "Për vetëqeverisjen Vendore"
  - e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8743 date 22.02.2001 ”Për pronat e paluajtshme të shtetit”.
  - f) Njohuritë mbi Ligjin Nr.9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, i ndryshuar
  - g) Ligjin 20/2020 Për përfundimin e proceseve kalimtare te pronesise ne Republiken e Shqiperise”
  - h) Ligji 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

**1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJEN PARALELE**  
**Kandidatët për lëvizjen paralele në këto pozicione pune do të vlerësohet si më poshtë:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. **Totali i pikëve është 40 pikë.**

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës,
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrieren

**Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë**

## 2. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

#### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a. Të ketë arsim të lartë në fushën përkatëse.
- b. Të zotërojnë arsimin nivelin Master Profesional ose Shkencor në Shkencat Inxhinierike/Natyres.
- c. Preferohet të këtë eksperience pune, në fushat përkatëse.

**2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës, (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njesimi nga Ministria Arsimit dhe Sportit
- c- Fotokopje e dëshmisë së gjuhës së huaj
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në **02.07.2026** Njësia e Menaxhimit të burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme.

**2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139 /2015 "Për vetëqeverisjen Vendore"
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8743 date 22.02.2001 ”Për pronat e paluajtshme të shtetit”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

f) Njohuritë mbi Ligjin Nr.9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, i ndryshuar

g) Ligjin 20/2020 Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

h) Ligji 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, **deri në 60 pikë;**

b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, **deri në 25 pikë;**

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, **deri në 15 pikë.**

**2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Bashkia Kruje do të shpallë fituesin në stendat e informimit të publikut, në faqen zyrtare të Bashkisë Kruje dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për rezultatet nëpërmjet (adresës së e-mail). Brenda pesë ditëve kalendarike nga njoftimi individët kanë të drejtë të paraqesin ankesa me shkrim pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

**KRYETARI**

**ARTUR BUSHI**